



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.06.2021)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:40 dhe mbaroi në orën 15:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Medi Bici*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen.

Vetëm zoti Bici nuk e ka të mundur të futet “online”.

Siç jeni në dijeni, për shkak të urgjencës, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është përcjellë projekt-akti lidhur me caktimin e gjyqtarëve në gjykatat që janë në nevojë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, fillimisht Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin “Për anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Krahas projektvendimit ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju parashtroj se me Vendimin nr.210, datë 20.05.2021, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, pikërisht pikën 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, paragrafi I, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar kërkesën e kësaj gjykate për caktim gjyqtari në një çështje gjyqësore, bazuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurat e caktimit

të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Konkretisht, Këshilli ka trajtuar kërkesën nr. {...} prot., datë 30.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe me vendimin e sipërpërmendur ka vendosur: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me kërkesë: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec etj.; I pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale “Vjedhje me dhunë” parashikuar nga neni 139 të Kodit Penal”.

Vendimi i Këshillit si më lart, me shkresën nr. {...} prot., datë 21.05.2021, i është njoftuar rregullisht gjyqtarit Besnik Shehu, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. {...} prot. datë 11.06.2021, dërguar me postë elektronike dhe protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 11.06.2021, ka njoftuar Këshillin se kërkesa e saj për caktimin e një gjyqtari në çështjen penale përkatëse ishte shqyrtuar nga Këshilli, fillimisht me Vendimin nr.192, datë 07.05.2021, me të cilin ishte caktuar në atë çështje penale gjyqtari {...}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa më pas, me Vendimin nr. 210, datë 20.05.2021, me të cilin ishte caktuar në atë çështje penale një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. {...}, ndërkohë që gjykimin e çështjes ishte caktuar për më datë 16.06.2021.

Në këtë rast, ligji i zbatueshëm është Kodi i Procedurave Administrative dhe konkretisht: neni 109, neni 113 dhe neni 117 i këtij kodi, sikundër edhe ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, konkretisht neni 97, pika 3 e tij.

Lidhur me arsyetimin ligjor mund t’ju parashtroj se gjatë veprimtarisë së tij ligjore Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh vullnetin nëpërmjet akteve administrative, të cilat rregullohen për nga forma dhe procedura e nxjerrjes prej Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Veprimtaria administrative e Këshillit konkretizohet me hartimin dhe nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat janë shfaqje të vullnetit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kanë për qëllim, krijimin, ndryshimin, apo shuarjen e pasojave të caktuara juridike.

Aktet e Këshillit, për nga forma apo përmbajtja e tyre, janë akte administrative me karakter të mirëfillte individual ose kolektiv, pasi nxirren në zbatim të një normë të përgjithshme, rregullojnë një çështje të caktuar, i drejtohen një numri të caktuar subjektësh, të cilët kanë kërkuar shprehjen e vullnetit të tij, si dhe evidentojnë qartë karakterin shterues të tyre. I tillë është edhe Vendimi nr.210, datë 20.05.2021, për të cilin nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është propozuar anulimi pjesërisht për sa i përket disponimit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Në rastin konkret, pas njoftimit të bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, u verifikua dhe u konstatua se kjo gjykatë, kërkesën për caktim gjyqtari e ka dërguar në Këshill me postë elektronike, duke u protokolluar me aktin nr. {...}, datë 04.05.2021. Po ashtu, kërkesa nga gjykata është dërguar edhe në rrugë postare, ku është protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 06.05.2021. Kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dërguar me postë elektronike dhe protokolluar me aktin nr. {...}, datë 04.05.2021, është trajtuar sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, fillimisht nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 05.05.2021, duke iu kaluar Këshillit për shqyrtim relacioni përkatës. Më pas, kërkesa e gjykatës dhe propozimet e Komisionit sipas relacionit përkatës, krahas kërkesave të gjykatave të tjera, janë shqyrtuar nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 07.05.2021, ku në përfundim është marrë Vendimi nr. 192, datë 07.05.2021, përmes të cilit, në çështjen penale të sipër përmendur, është caktuar gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. {...}. Ndërkohë, në ditët më pas, administrata e Këshillit (nëpunësi përgjegjës i ngarkuar për mbështetjen e Komisionit), duke mos vërejtur se kërkesa si më lart e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec tashmë ishte trajtuar nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 07.05.2021, ia ka referuar përsëri atë për trajtim Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pikërisht kërkesën e ardhur në rrugë postare. Mbi këtë bazë, kërkesa është shqyrtuar përsëri sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, ku në përfundim, me Vendimin nr. 210, datë 20.05.2021, në çështjen penale të sipër përmendur, është caktuar një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. Besnik Shehu. Nga sa rezulton, në rastin e dytë, Këshilli ka trajtuar një kërkesë të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec që në fakt ishte trajtuar më parë nga ai, pra duke mos pasur praktikisht në këtë rast një kërkesë të vlefshme për shqyrtim.

Mungesa e kërkesës së gjykatës në rastin e dytë cenon procedurën e nxjerrjes së aktit, pikërisht të Vendimit të Këshillit nr. 210, datë 20.05.2021, konkretisht paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, pika 1, prandaj, me qëllim shmangien e pasojave të një disponimi të tillë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për anulimin e pjesshëm të Vendimit nr.210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Me këtë projektvendim, Këshillit i propozohet që, bazuar në nenet 109, shkronja “b”, 113 dhe 117, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 97, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të vendosë: Anulimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, paragrafi I, të Vendimit nr.210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Ky është edhe propozimi për projektvendimin e propozuar.

Jeni dakord?

A ka kundërshtime?

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndaj propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.06.2021)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:40 dhe mbaroi në orën 15:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Brunilda Kadi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

9. Marçela Shehu (anëtare)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Medi Bici**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

2. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Kjo çështje e rendit të ditës ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Toska.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht radhën e shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm:

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

II. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe: Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Durrës; Gjykata e Apelit Korçë; Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Shkodër; Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: Z. Ded Miri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Alda Sadiku dhe Olti Skrame.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket mospërrjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Murat Lleshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Murat Lleshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Besnik Hoxha.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 6 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Bedri Qori; Z. Albert Meça; Znj. Armela Hasantari; Z. Lazër Sallaku; Z. Sokol Pasho; Z. Kujtim Vraniçi; Z. Gerd Hoxha; Z. Kastriot Gramshi; Z. Kreshnik Omari; Znj. Vjollca Spahiu; Z. Ahmet Metaliaj; Znj. Ardiana Bera; Z. Artan Gjermani; Znj. Migena Laska; Z. Altin Abdiu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Shefkije Mataj dhe Arben Micko.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2, dhe ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Arbër Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Besmir Stroka dhe Hasan Selimi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese janë:

Për çështjet nr.1-2, për të cilat kërkohen nga 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Për çështjen civile, atë nr.3, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Sa i përket përjashtimeve dhe mospërjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve nr.1-2 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që është me leje lindje, konkretisht: Znj. {...}.

Në shortimin e çështjes nr.3 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, konkretisht: Z. {...}.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të mos përjashtohen nga shorti Kryetaret në detyrë e këtyre gjykatave,

konkretisht: Znj. Alma Ahmeti (Zhupa); Znj. Flutura Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Alma Ahmeti.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Florin Demollari.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Flutura Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila është edhe anëtare e Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, konkretisht: {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Miranda Nakaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Arjeta Lika.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Saemira Hila.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Matilda Llangozi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Klejda Çapja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht: Z. Eriol Roshi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, konkretisht: Znj. Nafije Hasko.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtari Gentian Hamiti.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të

përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i cili është edhe anëtarë i Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, konkretisht: {...}.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, e cila u caktua me shortin e mëparshëm, atë të datës 10.06.2021, për të gjykuar një çështje gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, konkretisht: Znj. Etleva Gjamo.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtari Adrian Shega.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 3 në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për

rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit i sapo caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: {...}.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohet nga shorti kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Astrit Kalaja.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Fuat Vjerdha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i cili është thirrur në detyrë prej datës 05.03.2021, referuar për këtë nenit 149/2 të Kodit Zgjedhor, konkretisht: {...}; {...}.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, në 10 apo më shumë çështje gjyqësore, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrorjnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Artur Kalaja; Znj. Zegjine Sollaku.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale, të karakterit urgjent dhe tepër urgjent.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Iliba Bezati.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Skënder Damini.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 7 çështje gjyqësore, 3 në lëndë civile dhe 4 në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z. Izet Dushaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Florjan Kalaja dhe Anita Mici.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Igerta Hysi dhe Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët Izet Dushaj (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi (anëtarë).

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Igerta Hysi.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Florjan Kalaja (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarët Izet Dushaj dhe Igerta Hysi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale., të karakterit urgjent.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Në shortimin e çështjes nr.3 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj.Miranda Andoni.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Sokol Pina.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Miranda Andoni.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor